



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2539, datë 19.02.2015

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2508, datë 30.10.2014, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topciu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 19.02.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Rregulloren e Brendshme të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2508, datë 30.10.2014, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.”.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja n) e nenit 8, pika 1e nenit 114, pikat 1 dhe 2 të nenit 115 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.6.2010;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimin e Këshillit Drejtues 2508, datë 30.10.2014, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.”;
2. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 10708Prot. datë 17.11.2018, me anë të së cilës janë depozituar “Pretendimet me shkrim të Albtelecom sh.a. mbi procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit me Nisatel sh.p.k.”;
3. Raporti shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Raporti*), si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 2508, datë 30.10.2014, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.”, ka vendosur:
 - *Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.*”;
 - *Të njoftohen palët e interesuara Nisatel sh.a. dhe Albtelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;*
 - *Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit”;*
- II. Deri më datë 18.11.2014, nga Nisatel, nuk janë sjellë pretendime në lidhje me këtë mosmarrëveshje.
 - i. Sa më sipër, duke iu referuar pretendimeve mbi të cilat filloi ky procedim, në mënyrë të përmbledhur *paraqesim argumentet e Nisatel* në lidhje me këtë mosmarrëveshje:
 1. Lidhur me aplikimin nga Albtelecom sh.a., i tarifës së tranzitimit të thirrjeve nga rrjeti fiks Albtelecom në rrjetin Albetelcom Mobile, Nisatel kërkon mosaplikimin e kësaj tarife;
 2. Albtelecom sh.a. nuk lejon tranzitin e trafikut nga qendra tranzitore e Nisatel drejt OASH-ve për trafikun ndërkombëtar të mbledhur nga Nisatel dhe dedikuar OASH-ve. Nisatel, kërkon që të ndërpritet një abuzivitet i tillë nga Albtelecom sh.a. dhe mospengim i punës së operatorëve që operojnë në të njejtën fushë duke ua mohuar atyre te drejten e përzgjedhjes së operatorit nga i cili do te marrin tafikun e vet ndërkombëtar.
 3. Nisatel kërkon ndryshimin e tarifës Albtelecom sh.a. aplikon dhe ka më shumë se sa një vit që faturon pa të drejtë Nisatel për numrat e portuar në vlerën 600 Lek/numër.

- Nisatel Sh.p.k. ka kërkuar negocimin e tarifës, rregullimin e saj me një pikë të veçantë në marrëveshjen e interkoneksionit dhe ka propozuar vlerën 250 Lekë.
4. Albtelecom ka përcaktuar në draftin e MI dhe kërkon që të firmoset MI me përcaktimin e tarifës së terminimit të numrave të portuar Albtelecom në rrjetin Nisatel të barabartë me tarifën e trafikut kombëtar (*çëshjte e cila është trajtuar në vendimmarrjen e AKEP*).
 5. Nisatel ka kërkuar një pikë lokale interkoneksioni në qytetin Durrës, por Albtelecom e ka zvarritur implementimin dhe miratimin e kësaj kërkesë dhe nuk ka pranuar që kjo pikë interkoneksioni e kërkuar nga Nisatel të përfshihet në draftin e MI.

ii. Në lidhje me pretendimet e lartpërmendura të Nisatel, Albtelecom me anë të postës elektronike (depozituar më pas me shkresën nr. 10708Prot, datë 17.11.2014, nr. 2018/6Prot. i AKEP, datë 18.11.2014), ka dërguar prapësimet si vijon:

1. Albtelecom në këtë shkresë ka paraqitur në mënyrë kronologjike procesin e rinovimit dhe të nënshkrimit të marrëveshjes së re të interkoneksionit me Nisatel, duke theksuar se është ky i fundit përgjegjësi për këtë situatë, duke e zvarritur procesin.
2. Albtelecom shpjegon se, edhe pse Nisatel-it i janë shpjeguar dhe ofruar gjithë sqarimet e nevojshme duke iu referuar ORI-t të miratuar të Albtelecom dhe kuadrit rregullator në fuqi, Nisatel vijon në pretendime të padrejta, të ezauruara tashmë.
3. Albtelecom me shkresën nr. 4046Prot., datë 8.5.2014, ka njoftuar të gjithë operatorët alternativë (OA) për ORI e ri të miratuar nga AKEP, dhe u ka dërguar Draft Marrëveshjen e Re të Interkoneksionit (MI).
4. Albtelecom duke qenë se Nisatel është njoftuar disa herë dhe nuk i është përgjigjur procesin të nënshkrimit, njofton sërish me email të datës 23.6.2014, duke i kujtuar se ka kaluar çdo afat dhe po shkonte drejt mosfrimit të interkoneksionit.
5. Gjithsesi, Albtelecom me kërkesë të Nisatel zhvilloi takimin më datë 30.6.2014, ku u diskutuan kërkesat e tij, dhe në përfundim nga Albtelecom iu kërkuar plotësimi i dokumentacionit, për rinovimin e MI. Kjo kërkesë ndaj Nisatel, është përsëritur disa herë.
 - *Në lidhje me tarifën e tranzitimit nga rrjeti fiks në mobile*, Albtelecom është shprehur, se e ka sqaruar disa herë Nisatel, se është në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga Autoriteti i Konkurrencës (vendim nr. 201, datë 21.12.2011) dhe AKEP (vendim nr. 2337, datë 30.7.2013 dhe ORI) për ndarjen e llogarive.
 - *Në lidhje me moslejimin e tranzitit të trafikut nga qendra tranzitore e Nisatel drejt OASH-ve për trafikun ndërkombëtar të mbledhur nga Nisatel dhe dedikuar OASH-ve*, vendimi i AKEP nr. 2337, datë 30.7.2013, pika 6.3, shprehet se detyrimet e Albtelecom për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare sipas vendimit 1348, datë 26.7.2010 i ndryshuar, hiqen.
 - *Për tarifën prej 600 lekë për operatorin marrës në procedurën e portimit të numrave*, Albtelecom i referohet si Rregullores nr. 13, datë 16.4.2010, e ndryshuar ashtu edhe ORI të miratuar nga AKEP. Sa më lart, kjo tarifë është komerciale, dhe po zbatohet nga të gjithë operatorët njëloj.
 - *Për mosrënien dakord për tarifën e terminimit ndërkombëtar për numrat e portuar Albtelecom në rrjetin Nisatel, të barabartë me tarifën e trafikut kombëtar*, Albtelecom shprehet se kjo problematikë ka marrë zgjidhje me

vendimet e AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014; nr. 2503, datë 22.9.2014. Altelecom shpjegon se për këtë çështje është shprehur i hapur për negociata, por Nisatel po e zvarrit me qëllim.

- Lidhur me kërkesën për pikë lokale interkoneksioni në Durrës, Altelecom shprehet se, pas takimeve dhe sqarimeve të ofruara, Nisatel nuk ka depozituar dokumentacionin e plotë me të dhënat e kërkuara konform rregullave në fuqi.

Në përfundim, Altelecom shprehet se, nga ana e Nisatel është vënë re mungesë serioziteti dhe disponibiliteti përkundrejt të gjitha përpjekjeve dhe ndihmës së Altelecom për t'i dhënë zgjidhje të gjitha çështjeve të lartpërmendura.

III. AKEP, pasi ka shqyrtuar pretendimet e palëve gjykon se:

1. Lidhur me aplikimin nga Altelecom sh.a., të tarifës së tranzitimit të thirrjeve nga rrjeti fiks Altelecom në rrjetin Albetelcom Mobile, sqarojmë se Altelecom bazuar në vendimet për FNT për rrjetin fiks dhe rrjetin celular, ka detyrime për publikim të ofertave referencë të interkoneksionit (RIO) për shërbimet në rrjetin fiks (terminim, tranzitim dhe origjinim) dhe terminim në rrjetin celular. Bazuar në ofertat referencë të interkoneksionit Altelecom lidh marrëveshje interkoneksioni të vecanta për interkonektim në rrjet fiks dhe interkonektim në rrjet celular dhe kjo aplikohet me të gjithë operatorët fiks dhe celular.
2. Në lidhje me tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare, Altelecom nuk ka detyrime për këtë shërbim që prej datës 1.09.2010, pasi me Vendim nr.1348, datë 26.07.2010 të AKEP, Altelecom nuk ka më status me FNT për këtë shërbim. Detyrimet aktuale të Altelecom për tranzitim janë vetëm për FNT në tranzitimin e thirrjeve kombëtare sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 2337, date 30.07.2013, Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.
3. Në lidhje me tarifën e aplikuar midis operatorëve për portimin e numrit, AKEP ka vendosur vlerën tavan prej 600 lek për të gjitha llojet e portimeve dhe kjo tarifë është aplikuar midis operatorëve celulare dhe operatorë të rrjeteve fikse që prej fillimit të implementimit të portabilitetit të numrit. AKEP nuk gjykon se kjo vlerë është barrë e tepërt si dhe pretendimet për vlerë më të ulët (250 lek) nuk janë të shoqëruara me argumentim përkatës që të justifikojë përfshirjen e AKEP në rishikimin e kësaj tarife, process i cili do kërkonte përfshirjen e të gjitha palëve të interesuar për amendimin e Rregullores së Portabilitetit, nr. 13, datë 16.4.2010, e ndryshuar.
4. Në lidhje me çështjen e tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt numrave të portuar nga Altelecom në rrjetin Nisatel, AKEP ka trajtuar këtë çështje në vitin 2014 nëpërmjet Vendim Nr. 2489, datë 26.06.2014, për “Disa ndryshime në Oferten Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse”, Vendim nr.2497, datë 8.09.2014 për trajtimin e ankimeve administrative për Vendimin nr.2489, datë 26.06.2014, si dhe më specifikisht për marrdhëniet midis Nisatel dhe Altelecom me Vendimin nr.2503, datë 22.09.2014, për mbylljen e procedimit administrativ për mosmarrëveshjen midis Nisatel dhe Altelecom për çështjen e pretenduar.
5. Në lidhje me pretendimet për aksesin në pikë lokale interkoneksioni në Durrës, vërehet se Altelecom në shpjegimet e dhëna i ka dhënë sqarime Nisatel për plotësim dokumentacioni sipas kërkesave të RIO.

6. Propozimet e Albtelecom për Nisatel janë të njëjta me ato për operatorët e tjerë dhe nuk përbëjnë rast diskriminimi të Nisatel ndaj operatorëve të tjerë.
7. Për sa më sipër AKEP gjykon se pretendimet e palës pretenduese nuk justifikojnë ndërmarrjen nga AKEP të proceseve të ndryshimit të RIO të Albtelecom apo akteve të tjera të AKEP dhe palët duhet të procedojnë me nënshkrimin e amendamenteve përkatës të Marrëveshjes së Interkoneksionit.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A,

V E N D O S:

1. Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2508, datë 30.10.2014, *“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a.”*.
2. Nisatel sh.a. dhe Albtelecom sh.a. të nënshkruajnë amendamentet përkatëse të marrëveshjes së interkoneksionit midis tyre.
3. Ky vendim t’i njoftohet palëve të interesuara.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**